



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**VENDIM**

**K.P.P. 706/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|               |            |
|---------------|------------|
| Evis Shurdha  | Kryetar    |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj  | Anëtar     |
| Lindita Skeja | Anëtar     |
| Merita Zeqaj  | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 11.11.2019, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të BOE “Mane/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me nr. REF-33664-08-16-2019, me objekt: “Shtesë kati në objektin zyra të Drejtorisë së Rajonit Jugor Gjirokastër”, me fond limit 6,246,506 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
- Ankimues:** BOE “Mane/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k.  
Adresa: Lagjia nr.2, P.47, Sarandë.
- Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar  
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, nr.33, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### **Vlerësimi paraprak**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga BOE ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. BOE ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të BOE ankimues.

### II

#### **Rrethanat e çështjes**

II.1 Në datën 19.08.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me nr. REF-33664-08-16-2019, me objekt: “Shtesë kati në objektin zyra të Drejtorisë së Rajonit Jugor Gjirokastër”, me fond limit 6,246,506 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2 Në datën 30.08.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 05.09.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

|                                                 |                                    |
|-------------------------------------------------|------------------------------------|
| 1. “Elda - VI” sh.p.k.                          | pa ofertë ekonomike, Skualifikuar; |
| 2. ”Avduli” sh.p.k.                             | 4,675,298 lekë, Skualifikuar;      |
| 3. “Mane/S” sh.p.k. & ”BE-IS” sh.p.k.           | 5,492,372 lekë, Skualifikuar;      |
| 4. “Jody Kompany” sh.p.k. & ”Shendelli” sh.p.k. | 5,806,562 lekë, Skualifikuar;      |
| 5. “Inerti” sh.p.k.                             | 6,225,516 lekë, Kualifikuar;       |

II.4.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar BOE “Mane/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“BOE MANE-S SHPK dhe BE – IS SHPK skualifikohet se nuk ka dorezuar dokumentacion te sakte lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor te kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe te Vecanta te

Kualifikimit te pershkruara ne DST, konkretisht: 1. Operatori MANE/S shpk nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.5 te kriterëve te veçanta per kualifikim (nuk ka arritur te paraqese Licencë QKL III.2.B) Referuar natyres dhe volumit te punimeve te marra persiper nga MANE/S shpk ne akt marreveshjen e bashkepunimit rezulton se ky operator ka marre persiper te kryeje 93.43 % te punimeve, kurse BE – IS sh.p.k ka marre persiper te kryeje 6.57 % te punimeve. BE – IS SH.P.K ka marre persiper te kryeje punime germimi, punime prishje, punime murature vetem zeri mur tulle e plote t= 25 cm me llac perzier M-25. Disponimi i kesaj liçence nuk ka te beje vetem me germim dheu, punime prishje, por edhe me transportin e mbetjeve, e grumbullimin e materialeve inerteve, dherave, etj. Mosdisponimi nga MANE-S shpk i kesaj liçence konsiderohet mosplotesim i pikes 2.3.5 te kriterëve te veçanta per kualifikim dhe perben shkak per skualifikim te BO. Kjo, sepse ne nenin 74 te VKM 914/2014, pika 3, secili prej pjesetareve te BO kriteret ekonomiko - finaciare, teknike e profesionale duhet t'i plotesoje ne perputhje me % dhe natyren e puneve te marre persiper ne akt marreveshjen e bashkepunimit. 2. Operatori MANE-S shpk nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.3 te kriterëve te veçanta per kualifikim lidhur me disponimin e punonjesve te kualifikuar si teknik ndertimi, elektrikist, mekanik, pllakashtrues, hidroizolues, e karpentier, bojaxhi, muratore/suvatues, hidraulike, bojaxhi, ne proporcion me nr qe i duhet te kishte sipas % te marre persiper ne akt marreveshjen e bashkepunimit 93.43 %. Keshtu, operatori MANE-S shpk ka paraqitur çertifikata trajnimi dhe deshmi te sigurimit teknik, te cilat leshohen nga subjekte juridikë jo publikë (privatë) me kusht që këto të fundit të jenë të çertifikuar (akredituar) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit. Por keto deshmi te paraqitura nuk provojne se personat qe i disponojne ato jane ne profesionet e kerkuara. Kjo, sepse nuk te ben teknik ndertimi, elektriciist, apo hidraulik deshmi se je trajnuar per te perdorur pajisjet elektrike e dhene ndihmen e pare ne rast renie ne kontakt me rrymen elektrike por zanatçi, specialist, profesionist te nje fushe te caktuar te ben shkolla apo kursi profesional. Ne ndryshim nga kualifikimi per perdorimin e pajisjeve elektrike, “Kualifikimi profesional” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat mundësojnë ushtrimin me sukses të një aktiviteti të caktuar profesional, i cili mund të përftohet nëpërmjet mësimnxënies te një ofrues i Agjencise se Formimit Profesional, i përmbyllur me provime dhe i çertifikuar nëpërmjet një dokumenti përkatës (çertifikatë). Dokumenti qe duhet paraqitur per te deshmuar kualifikimin profesional jane: Çertifikatat/dëshmitë/diplomat” te cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar. Keto Çertifikata/dëshmi/diploma jane leshuar apo leshohen nga shkollat profesionale, apo qendrat e formimit profesional, te cilat jane njohur e akredituar ligjerisht nga Agjencia e Formimit profesional sipas percaktimeve te ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” apo shkollat profesionale e qendrat e formimit qe kane ekzistuar ne Shqiperi deri ne hyrjen ne fuqi te ligjit Nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. Per sa me siper, mosparaqitja e dokumentacionit si (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë) të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm konsiderohet mosplotesim i pikes 2.3.3 te kriterëve te veçanta per kualifikim nga operatori MANES qe sipas akt marreveshjes ka marre persiper te kryeje 93.43 % te punimeve”

II.5.Në datën 09.09.2019, BOE “Mane/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 8300/1 Prot. datë 13.09.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimes “Mane/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.7.Në datën 18.09.2019, BOE “Mane/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

*“[...]Sa me poshte parashtrojme argumentat tona mbi arsyet e skualifikimit: 1.Persa i perket pikes se pare te s'kualifikimit sqarojme se oferta jone eshte paraqitur si bashkim operatoresh “MANE/S” sh.p.k dhe “BE-IS” sh.p.k, bashkim i cili eshte krijuar ne respektim te nenit 74 te VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Regullat e prokurimit Publike” i ndryshuar, me kontrate bashkepunimi nr. 3862 rep. dhe nr.792 kol. date 27.08.2019, ne te cilen percaktohen raportet : “MANE/S” sh.p.k 93.43% “BE-IS” sh.p.k 6.57%. Perkatesisht shoqeria “BE-IS” sh.p.k ka marre persiper punimet e parashikuara ne preventivin e objektit te prokurimit (citohet tabela....)*

*Sic rezulton shoqeria BE-IS sh.p.k ka marr persiper te gjitha punimet qe parashikohen ne preventiv dhe qe lidhen ngushtesisht me objektin e Liçencës QKL III.2.B. (Grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme). Cfare objekti ka ne vetevete kjo licence, grumbullim dhe transport te mbetjeve jo te rrezikshme. Po te kujt mbetjeve ne kete rast, sigurisht te atyre qe jane parashikuar ne preventivin e objektit te prokurimit. Sic sqaruar me lart te gjitha punimet e preventivit qe lidhjen me grumbullimin e mbetjeve dhe transportin e tyre, seksioni I (punime germimi) dhe II (punime prishje) jane marr persiper 100% nga shoqeria BE-IS sh.p.k e cila disponon edhe Liçencë QKL III.2.B. (Grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme).Shoqeria Mane/S sh.p.k nuk ka marre persiper asnje ze prishje apo germimi qe ne menyre indirekte do ta lidhte me disponimin e kesaj License. Ajo qe KVO shprehe ne argumentimin e skualifikimit tone per piken e pare, cit\*: ....Disponimi i kesaj licence nuk ka te beje vetem me germim dheu, punime prishje por edhe me transport te mbetjeve dhe grumbullimin e materialeve inerte dhe dherave etj... minimalisht eshte lajthithje ne mos eshte e qellimshme per skualifikimin tone te padrejte. Ne seksioni I (punime germimi) dhe II (punime prishje) te marra persiper nga BE-IS sh.p.k per punime germimi dhe prishje perfshihen edhe zerat e punimit : seksioni I (punime germimi) 2.Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 6.0 km; seksioni II (punime prishje) 5.Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 6.0 km;*

*Pra KVO me qellim ben sikur si shikon keto zera per te ligjeruar s'kualifikimin e padrejte lidhur me disponimin e Liçencës QKL III.2.B. (Grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme). Shoqeria MANE/S sh.p.k nuk ka marre persiper asnje ze (shiko me lart tabelen e zerave sipas ndarjes se punimeve) i cili lidhet me grumbullimin apo transportin e mbetjeve jo të rrezikshme. Ligjvenesit ka parashikuar mundesine e paraqitjes se ofertes si bashkim operatoresh me qellimi krijimit e mundesive edhe per biznesin e vogel dhe te mesem, si dhe te gjithe operatorëve te interesuar per te marre pjese ne gare, duke repektuar keshtu parimet e nenit 1 te LPP, qe të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, qe të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Nepermjet nenit 74 te VKM 914, ligjvenesit i krijon mundesine*

*bashkimit te operatoreve qe te bashkojne kapacitetet ekonomik, financiare, profesionale dhe teknike si nje grup i vetem, me qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi. Ne kete prizem shoqerite pjese e BO bashkojne kapacitet e veta per te plotesuar kriteret e vendosura ne DT, me qellim realizimin e punimeve si nje grup i vetem.*

*Per te vazhduar aty ku e lam me siper, theksojme se KVO ka vendosur ne kundeshtim me parashikimet e nenit 74 te VKM 914, pasi me dashje shprehen qe shoqeria "BE -IS" sh.p.k nuk ka marre persiper edhe transportin e mbetjeve jo te rrezikshme, ndonese nje gje e tille nuk eshte e vertete dhe provohet nepermjet tabelës se ndarjes se punimeve seksioni I dhe II, te cilet perfshijne nder te tjera edhe zerin e transportit sic sqaruam me larte. Pra shoqeria "MANE/S" sh.p.k nuk ka pse te kete Liçencë QKL III.2.B. (Grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme), persa kohe nuk ka marre persiper asnje punim qe lidhet me kete license. Vendimi i KVO vjen ndesh me nenin 2, 20, 46, 55/2 te LPP dhe me nenin 26, 66 dhe 74 te VKM 914, pra skualifikimi jone eshte bere ne menyre te padrejte edhe pse ne plotesojme ne menyre korrekte kerkesen e parashikuar ne 2.3.5 te kriterëve per kualifikim.*

*2.Persa i perket pikes se dyte te s'kualifikimit, ne te cilen KVO shprehet cit\* : Operatori MANE/S sh.p.k, nuk ka arritur te paraqes dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.2, te kriterëve te vecanta per kualifikim lidhur me disponimin e punonjesve te kualifuar si teknik ndertimi, elektrikist, mekanik, pllakashtrues, hidroizolues, karpentier, bojaxhi, muratore/suvatues, hidraulik ne proporcion me nr.. qe duhet te kishte sipas % te marre persiper ne akt marreveshje e bashkepunimit 93.43 %. Keshtu Operatori MANE/S sh.p.k, ka paraqitur certifikata trajnimi dhe deshmi te sigurimit teknik qe leshohen nga subjekte juridike jo publike (private) me kusht qe keto te fundit te jene te certifikuara (akredituara) ne perputhje me kuadrin ligjore ne fuqi nga Drejtoria e Pergjithsme e Akreditimit. Por keto deshmi te paraqitura nuk provojne se personat qe i disponojne ato jane ne profesionet e kerkuara ..... Lidhur me kete pike sqarojme qe ne DT, AK ka kerkuar ne pike 2.3.3 te kriterëve:*

*Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se ka në stafin e tij minimumi 12 punonjës kualifikuar, ndër të cilët të paktën:*

*-2 elektrikistë*

*-2 hidraulikë*

*-1 teknikë ndërtimi*

*-1 hidroizolues*

*-1 karpentier*

*- 2 muratorë suvatues*

*-1 bojaxhi*

*-1 punonjës për sistemet e kondicionimit  
si dhe*

*-1 punonjës ekspert zjarrfikës (me certifikatë nga Drejtoria e PMZSH)*

*Per punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten: Kontratë pune, dokument (dëshmi kualifikimi profesional certifikatë/diplomë) të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj. që të vërtetojnë kualifikimin profesional të mësipërm. Këto punonjës të figurojnë në listëpagesa, të paktën për periudhën Janar 2019-Qershor 2019.*

*Referuar dokumentacionit te paraqitur ne SPE rezulton qe BO "MANE/S" sh.p.k dhe "BE-IS" sh.p.k kane paraqitur me shume se dy fishin e numerit te kerkuar te punonjesve te kualifikuar, ne kete pike, shoqeruar me dokumentacion te plote sic kerkohet ne piken 2.3.3, Kontrate pune, deshmi kualifikimi/certifikatë/diplomë të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale*

të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm, te cilet figurojnë në listëpagesa, për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.

Perkatesisht MANE/S sh.p.k ka paraqitur :

- 2 (dy) teknik ndertimi,

Teknik ndertimi M. M. shoqeruar me diplome nr. 10 te shkolles se mesme ne degen teknik i mesem ndertimi, me kontrate pune dhe deshmi kualifikimi te sigurimit teknik, qe figuron ne listëpagesa, për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019;

Teknik ndertimi S. Sh. shoqeruar me diplome te shkolles se mesme teknike te ndertimit ne degen ndertim, me kontrate pune dhe deshmi kualifikimi te sigurimit teknik;

S. Sh., eshte diplomuar ne degen ndertim ne shkollen e mesme te ndertimit, dhe ka ndjekur studimet ne vitin 1985-1989 dhe sipas vertetimit dt.18.11.2015, qe provon qe ky person ka perfunduar studimet ne degen ndertim ne shkollen e mesme te ndertimi. Pra nuk eshte e vertete qe nuk kemi paraqitur deshmi kualifikimi/ certifikatë/diplomë të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale të njohura, apo te" akredituara nga shteti, etj

- 2 (dy) Elektracist

Elektracist M. Xh., i pajisur me certifikate trajnimi, per elektracist te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, kartelet sigurimi teknik si elektracist te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.

Elektracist A. M., i pajisur me certifikate trajnimi, per elektracist te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe me certifikate te pergatitjes profesionale nr. Rregjistri 1325 per elektromekanik, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, kartelet sigurimi teknik si elektracist te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.

- 2 (dy) hidraulikë

Hidraulik L. J. i pajisur me certifikate trajnimi, per Hidraulik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.

Hidraulik A. H. i pajisur me certifikate trajnimi, per Hidraulik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) deshmi nr.3810 leshuar nga Shkolla Profesionale e Ekonomise Komunale Tirane, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, kartelet sigurimi teknik si Hidraulik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.

- 1 (nje) hidroizolues

Hidroizolues A. R. i pajisur me certifikate trajnimi si Hidroizolues, te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe kartelet sigurimi teknik si Hidroizolues te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, kartelet sigurimi teknik dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.

- 1 (nje) karpentier

*F. Xh. i pajisur me certifikate trajnimi, per karpentier te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, kartelesigurimi teknik si karpentier te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*muratorë/suvatues*

*Murator E. B. i pajisur me certifikate trajnimi, per murator te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrale pune, kartelesigurimi teknik si murator te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

- 1 (nje) bojaxhi

*Bojaxhi M. M. i pajisur me certifikate trajnimi, per bojaxhi te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, kartelesigurimi teknik si murator te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*Te gjitha certifikatat e trajnimit te paraqitura per punonjesit e mesiperm jane leshuar ne perfundim te sesionit trajnues sipas afateve perkatese nga organe të akredituara nga shteti DPA, per realizimin e ketyre trajnimeve dhe leshimin e certifikatave te trajnimit ne profesionet perkatese.*

*Shoqeria BE-IS sh.p.k nga ana e saj ka paraqitur :*

*- muratorë/suvatues*

*S. M. i pajisur me deshmi kualifikimi per murator te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelesigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*B. Z. i pajisur me deshmi kualifikimi per murator te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelesigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*- Elektricist*

*D. M. i pajisur me deshmi kualifikimi per elektrikist te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres + certifikate trajnimi, te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelesigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*S. I. i pajisur me deshmi kualifikimi per elektrikist te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres + certifikate trajnimi, te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelesigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*H. B. i pajisur me Deftese leshuar nga Drejtoria e Arsimit Bulqize, Shkolla e Mesme Teknike Elektrike per elektrikist te leshuar, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate*

*pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*S. Sula i pajisur me deshmi kualifikimi per elektrikist te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*B. T. i pajisur me deshmi kualifikimi per elektrikist te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*Q. M. i pa jisur kartelet sigurimi teknik si elektrikist te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019*

#### *- Bojaxhi*

*V. G. i pajisur me deshmi kualifikimi per Bojaxhi te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*A. T. i pajisur me deshmi kualifikimi per Bojaxhi te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*K. M. i pajisur me deshmi kualifikimi per Bojaxhi te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres + certificate trajnimi, te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

#### *- Hidraulik*

*R. K. i pajisur me deshmi kualifikimi per Hidraulik te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres + certificate trajnimi, te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA), CV dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*Sh. K. i pajisur me deshmi kualifikimi per Hidraulik te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres + certificate trajnimi, te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA), CV dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*Z. Z. i pajisur me deshmi kualifikimi per Hidraulik te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres + certificate trajnimi, te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqëri e akredituar nga shteti (DPA), CV dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*F. N. i pajisur me deshmi kualifikimi per Hidraulik te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres + certificate trajnimi, te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*H. H. i pajisur me deshmi kualifikimi per Hidraulik te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres + certificate trajnimi, te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*- Teknik Nderimi*

*P. D. i pajisur me Deftese Pjekurie per Teknik Ndertimi te leshuar shkolla e Mesme Ferizaj, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), CV dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*i pajisur me Deftese Pjekurie per Teknik Ndertimi te leshuar Shkolla e Mesme e Ndertimit "Karl Gega" sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA), CV dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*- Karpentier*

*I. M. i pajisur me deshmi kualifikimi per Karpentier te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*V. H. i pajisur me deshmi kualifikimi per Karpentier te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*R. T. i pajisur me deshmi kualifikimi per Karpentier te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*M. H. i pajisur me deshmi kualifikimi per Karpentier te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

*M. L. i pajisur me deshmi kualifikimi per Karpentier te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, kartelet sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019.*

- Murator/suvatues

X. T. i pajisur me deshmi kualifikimi per murator/suvatues te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, karte sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa per periudhen Janar 2019 - Qershor 2019.

E. K. i pajisur me deshmi kualifikimi per murator/suvatues te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3. 3, shoqeruar me kontrate pune, karte sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa per periudhen Janar 2019 - Qershor 2019.

- Hidroizolues

M. H. i pajisur me deshmi kualifikimi per Hidroizolues te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, karte sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa per periudhen Janar 2019 - Qershor 2019.

F. S. i pajisur me deshmi kualifikimi per Hidroizolues te leshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres, sic edhe parashikohet ne piken 2.3.3, shoqeruar me kontrate pune, Libreze pune, karte sigurimi teknik te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA) dhe figuron ne listpagesa per periudhen Janar 2019 - Qershor 2019.

Referuar preventivit te ndarjes se punimeve shoqeria BE-IS sh.p.k ka marre persiper edhe zera qe lidhen direkt me profesionet e muratorit/teknikut te ndertimit/hidroizoluesit cka do te thot se pika 2.3.3 duhet te plotesohet bashkarisht nga te dy anetaret e bashkimit te operatoreve dhe jo vetem nga njeri operator. Ne kuptim te nenit 74 te VKM 914, Bashkimi i Operatoreve vepron si nje grup i vetem i cili bashkon mjetet financiare, kapacitetet teknike me qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi. Qendrimi i KVO lidhur me kete pike eshte shume siperfaqesor, i padrejte dhe diskriminues, pasi shoqeria Mane/S sh.p.k nuk konkuron e vetme ne kete procedure, dhe si e tille te gjitha kapacitetet duhet ti plotesoje 100% vetem, ajo konkuron si pjese e Bashkimit te Operatoreve, te krijuar ne baze te kontrates se bashkepunimit, ne te cilen jane percaktuar edhe te drejtat dhe detyrimet per secilen pale. Ne kontraten e bashkepunimit te dates 27.08.2019, eshte parashikuar se: Shoqerite do te vene ne dispozicion te objektit te mesiper sebashku kapitalin financiar dhe intelektual, makinerite dhe personelin teknik qe disponojne duke punuar si nje grup i vetem. Shoqerite mbajne pergjegjesi te plote per realizimin e punimeve dhe dorezimin e objektit ne menyre te barabarte dhe detyrimet ndaj shtetit dhe te treteve jane ne ngarkim te shoqerive. Punimet e parashikuara dhe ato te paparashikuara referuar listes se volumeve te dhena nga punedhenesi do te kryhen nga shoqerite si nje program i vetem.

Pra Bashkimi i Shoqerive garon si nje program i vetem i cili ka bashkuar te gjitha kapitalin financiar, intelektual, makineri/pajisjet dhe personel teknik te deklaruar ne SPE, per te realizuar kontraten si nje i vetem duke marre persiper pergjegjesi te plote per realizimin e punimeve dhe dorezimin e objektit ne menyre te barabarte, per te gjitha punimet e parashikuara dhe te paparashikuara ne listen e volumeve te dhena nga AK, te cilat i merr persiper ti realizoje si nje grup i vetem.

Te dyja shoqerite kane deklaruar, ne kete procedure prokurimi te gjitha kapacitetet totale, dhe jo vetem ne baze te %, cka do te thote qe kane marre angazhimin qe te bashkojne te gjitha kapacitetet qe disponojne per ta realizuar kete kontrate si nje grup i vetem, me pergjegjesi te barabarta. Ne kuptim te nenit 74 te VKM 917 BO permbushe dhe tejkalon kerkesat e pikes 2.3.3 per staf teknik, sic

sqaruar ne menyre te detajuar me siper. Edhe sikur vec e vec te kishin garuar keto kompani i plotesojne kerketat per staf te kualifikuar sic kerkohet ne piken 2.3.3. Te dyja shoqerite pjese e bashkimit te operatoreve, edhe vecmas zoterojne kapacitete teknike shume me te medha se ato te vendosura ne tender, ndaj ato permbushin dhe tejkalojne kriteret e vendosur nga ARSH. Me keqardhje verejme qe KVO ka mbajtur qendrim teper te sforcuar dhe dashakeq, ne tejkallim edhe te parashikimeve te nenit 55/2 te LPP i cili parashikon se : Autoriteti kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, per te percaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

duke perdorur kriteret te cilat nuk jane parashikuar ne DT.

Ne DT kerkohet qe: Per punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten: Kontratë pune, dokument (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë) të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj që të vërtetojnë kualifikimin profesional të mësipërm. Persa i perket certifikate trajnimi (qe kemi paraqitur) te leshuar nga shoqerie e akredituar nga shteti (DPA organ shteteror) nuk e kuptojme nga e merr kompetencen KVO per te konsideruar te pavlefshme keto certifikata te cilat jane leshuar nga organe te akredituara nga shteti, te cilat kane te drejte te zhvillojne kurse trajnimi per profesione te ndryshme dhe ne fund te sesionit trajnues te leshojne certifikate qe vertetojne kualifikimin profesional perkates. Ne cdo certifikate eshte shenuar edhe titulli profesional qe kane perftuar personat e trajnuar si hidraulik, elektrikist, murator, etj. Vete KVO shprehet qe Mane /S sh.p.k ka paraqitur certifikata trajnimi te cilat leshohen nga subjekte private te certifikuar nga institucionet shteterore Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit. Pasi e pranon qe jane dorezuar certifikatat shprehet qe keto certifikata nuk provojne qe personat qe i disponojne ato jane ne profesionet e kerkuara. Sqarojme qe kjo nuk eshte e vertete pasi si ne certifikatat e trajnimit te leshuar nga organi i akredituar nga shteti DPA ashtu edhe kartelat e sigurimit teknik te paraqitura e kane te shenuar fushen e kualifikimit si bojaxhi, murator, hidroizolues, karpentier, hidraulik, etj si dhe japin informacion mbi trajnimin e kryer, fushen e trajnimit, datat e zhvillimit te trajnimit dhe kualifikimin perkates, titullin. Ne keto kushte KVO pranon qe kemi paraqitur certifikata te leshuara nga organe te akredituara nga shteti DPA ne kete rast por sipas opinionit te KVO keto sprovujne asgje, edhe pse kane te percaktuar shprehimisht kualifikimin perkates, titullin e perftuar me certifikat. Kjo eshte absurde dhe ne tejkallim te nenit 55/2 te LPP, ndaj kerkojme nga KPP ta shqyrtoje me objektivitet kete pike dhe te ndryshoje vendimin per skualifikimin tone ne menyre te padrejte ndonese kemi paraqitur certifikatat e kualifikimit sic jane kerkuar ne DT. Per me teper, vete AK, nuk i ka percaktuar ne menyre shteruese dokumentat që vërtetojnë kualifikimin profesional të kerkuar sepse pasi rendite disa forma e le te hapur mundesine duke thene ETJ. cka do te thote pranon cdo lloj dokumenti qe provon kualifikimin e kerkuar ku mund te futen edhe kartelat e sigurimit teknik te cilat leshohen nga kompani te akredituara nga DPA agjenci shteterore e ngarkuar me ligj.

Vete KVO shtrehet te specialist te ben kursi professional dhe nga ana tjeter certifikatat e trajnimit te perftuara nga organe te akredituara nga shteti te cilat jane dhene ne perfundim te realizimit te kursit professional i konsideron te pavlefshme???? Ky qendrim eshte ne kundesthim si me kriterin por edhe me rrjedhen llogjike te vete arsytimit te KVO. Ne certifikatat e paraqitura nga Mane/S sh.p.k ka te renditura ne menyre te detajuar te gjitha etapat e trajnimit te realizuar gjate zhvillimit te kursit te kualifikimit, ka te percaktuar daten e fillimit dhe te mbarimit te kursit te kualifikimit sistemin e njohurive te perftuara dhe cdo gje tjeter qe perfshin nje certifikate. Ndaj qendrimi i KVO eshte siperfaqesor i njeanshem i padrejte dhe diskriminues.[...]

II.8.Në datën 02.10.2019, me anë të shkresës nr.8692/1prot., datë 30.09.2019, ka mbërritur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të BOE ankimues,

#### Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e BOE “Mane/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: [...]2. Operatori MANE-S shpk nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plote dhe të sakte për të deshmuar plotësimin e pikes 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim lidhur me disponimin e punonjesve të kualifikuar si teknik ndertimi, elektrikist, mekanik, pllakashtrues, hidroizolues, e karpentier, bojaxhi, muratore/suvatues, hidraulike, bojaxhi, në proporcion me nr që i duhet të kishte sipas % të marre persiper në akt marreveshjes e bashkepunimit 93.43 %. Kështu, operatori MANE-S shpk ka paraqitur çertifikata trajnimi dhe deshmi të sigurimit teknik, të cilat leshohen nga subjekte juridikë jo publikë (privatë) me kusht që këto të fundit të jenë të çertifikuar (akredituar) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit. Por keto deshmi të paraqitura nuk provojnë se personat që i disponojnë ato janë në profesionet e kerkuara. Kjo, sepse nuk të ben teknik ndertimi, elektrikist, apo hidraulik deshmia se je trajnuar për të përdorur pajisjet elektrike e dhene ndihmen e pare në rast rënies në kontakt me rrymen elektrike por zanatçi, specialist, profesionist të një fushe të caktuar të ben shkollë apo kurs profesional. Në ndryshim nga kualifikimi për përdorimin e pajisjeve elektrike, “Kualifikimi profesional” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat mundësojnë ushtrimin me sukses të një aktiviteti të caktuar profesional, i cili mund të përftohet nëpërmjet mësimnxënies të një ofruesi i Agjencisë së Formimit Profesional, i përmbyllur me provime dhe i çertifikuar nëpërmjet një dokumenti përkatës (çertifikatë). Dokumenti që duhet paraqitur për të deshmuar kualifikimin profesional janë: Çertifikatat/dëshmitë/diplomat” të cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar. Keto Çertifikata/dëshmi/diploma janë leshuar apo leshohen nga shkollat profesionale, apo qendrat e formimit profesional, të cilat janë njohur e akredituar ligjorisht nga Agjencia e Formimit profesional sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” apo shkollat profesionale e qendrat e formimit që kanë ekzistuar në Shqipëri deri në hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. Për sa më sipër, mosparaqitja e dokumentacionit si (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë) të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkollat profesionale të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj që të vërtetojnë kualifikimin profesional të mësimprerës konsiderohet mosplotësim i pikes 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim nga operatori MANES që sipas akt marreveshjes ka marrë persiper të kryejë 93.43 % të punimeve [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën 11, pika 2.3.3 “Për kapacitetin teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“•Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se ka në stafin e tij minimumi 12 punonjës të kualifikuar, ndër të cilët të paktën:

- 2 elektrikistë
- 2 hidraulikë
- 1 teknikë ndërtimi
- 1 hidroizolues
- 1 karpentier
- 2 muratorë/suvatues
- 1 bojaxhi
- 1 punonjës për sistemet e kondicionimit

si dhe

- 1 punonjës ekspert zjarrfikës (me certifikatë nga Drejtoria e PMZSH)

Per punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten: Kontratë pune, dokument (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë) të lëshuara nga qendra e formimit profesional, shkolla profesionale të njohura, apo të akredituara nga shteti, etj që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm.

Këto punonjës të figurojnë në listëpagesa, të paktën për periudhën Janar 2019 - Qershor 2019”

III.1.2. Operatorët ekonomikë “Mane/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k., kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit të lidhur para një noteri Nr.3862Rep., Nr.792Kol. Referuar kontratës së bashkëpunimit të mësipërme parashikohet se “ [...]Në këtë bashkëpunim shoqëritë do të përfaqsohen në raportet si më poshtë:

Shoqëria “Mane/S” sh.p.k., 93.43%.

Shoqëria “BE-IS” sh.p.k., 6.57%.

Shoqëria “BE-IS” sh.p.k. do të kryej këto punime: I. PUNIME GERMIMI; II. PUNIME PRISHJE; ndërsa tek GRUPI III. PUNIME MURATURE do të kryej vetëm zërin nr.1 Mur tulle e plotë t=25 cm me llac të përzier

Shoqëria “Mane/S” sh.p.k. do të kryej këto punime: të gjithë punimet e tjera që kanë mbetur në preventiv përvec punimeve që ka marrë përsipër shoqëria BE-IS” sh.p.k. [...]”

III.1.3.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.1.4.Neni 74, pika 1, 2 dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi..... 2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së

*punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.1.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE ankimues, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Operatori ekonomik ”Mane/S sh.p.k ka paraqitur :

- M. M. shoqëruar me diplomë nr. 10 të shkollës së mesme në degën teknik i mesëm ndërtimi, me kontratë pune dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik;
- S. Sh. shoqëruar me diplomë të shkollës së mesme teknike të ndërtimit në degën ndërtim, me kontratë pune dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik;
- M. Xh., shoqëruar me certifikatë trajnimi, për Elektracist të lëshuar nga AQScert, kontratë pune, kartelë siguri teknik.
- A. M., shoqëruar me certifikatë trajnimi, për Elektracist të lëshuar nga AQScert dhe me certifikatë të përgatitjes profesionale nr. Rregjistri 1325 për elektromekanik, kontratë pune, kartelë siguri teknik.
- L. J. shoqëruar me certifikatë trajnimi, për Hidraulik të lëshuar nga AQScert, kontratë pune, kartelë siguri teknik, si dhe certifikatë trajnimi/seminari.
- A. H. shoqëruar me certifikatë trajnimi, për Hidraulik të lëshuar nga AQScert, dëshmi nr.3810 lëshuar nga Shkolla Profesionale e Ekonomisë Komunale Tiranë, kontratë pune, kartelë siguri teknik.
- A. R. shoqëruar me certifikatë trajnimi për Murator, të lëshuar nga AQScert, kartelë siguri teknik, kontratë pune.
- F. Xh. shoqëruar me certifikatë trajnimi, për Karpentier të lëshuar nga AQScert, kontratë pune, kartelë siguri teknik.
- E. B. shoqëruar me certifikatë trajnimi, për Murator të lëshuar nga AQScert, kontratë pune, kartelë siguri teknik.
- M. M. shoqëruar me certifikatë trajnimi, për Bojaxhi të lëshuar nga AQScert, kontratë pune, kartelë siguri teknik.
- L. G. shoqëruar me certifikatë profesionale, për instalues dhe riparues kondicionerë të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Tiranë, kontratë pune.

Operatori ekonomik ”BE-IS” sh.p.k, ndër të tjera ka paraqitur :

- S. M. shoqëruar me Dëshmi kualifikimi për murator të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durrës, kontratë pune, librezë pune, kartelë siguri teknik.

- B. Z. shoqëruar me Dëshmi kualifikimi për murator të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durrës, kontratë pune, libeze pune, kartelë sigurimi teknik.
- P. D. shoqëruar me Dëftesë Pjekurie për Teknik Ndërtimi të lëshuar nga Shkolla e Mesme Ferizaj, kontratë pune, librezë pune, kartelë sigurimi teknik, CV.
- I. I. shoqëruar me Dëftesë Pjekurie për Teknik Ndërtimi të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Ndërtimit "Karl Gega", kontratë pune, librezë pune, kartelë sigurimi teknik, CV.

III.1.6. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 26 "Kontratat për Punë Publike" pika 8 përcaktohet se: *"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon"*

a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*

b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*

c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të sipërcituar të paraqitur nga ankimuesi në përmbushje të kriterit kualifikues, lidhur me disponueshmërinë e punonjësve të kualifikuar, konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë "Mane/S" sh.p.k., referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër të përmbushë 93.43% të kontratës objekt prokurimi, si dhe referuar zërave të preventivit të marrë përsipër për të kryer, ky i fundit duhet të dëshmonte me anë të dokumentacionit se disponon 2 (dy) Elektracist; 2 (dy) Hidraulik; 1 (një) Teknik Ndërtimi; të paktën 1 (një) Murator/Suvatues; 1 (një) Bojaxhi; 1 (një) Karpentier; 1 (një) Hidroizolues. Nga verifikimi i kryer në dokumentacionin e dorëzuar në përmbushje të kriterit të vecantë të kualifikimit, Komisioni konstaton se, operatori ekonomik "Mane/S" sh.p.k., për të vërtetuar kualifikimin profesional për punonjësit Karpentier, Bojaxhi, Murator, si dhe për një Elektracist, ka paraqitur certifikata për pjesëmarrje në kurse trajnimi të lëshuara nga organizmi certifikues AQScert, për specialitetet e mësipërme, me module të cilat variojnë nga 12 orë deri në 32 orë. Komisioni sqaron se, me anë të kriterit të vendosur, autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomik të dëshmojnë se disponojnë stafin teknik të kualifikuar profesionalisht në profesionet e kërkuara në dokumentat e tenderit, të cilët nevojiten për të zbatuar me sukses kontratën objekt prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë "Mane/S" sh.p.k. nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për paraqitjen e punonjësve të kualifikuar, pasi me anë të certifikatave të kursit të lëshuara nga organizmi certifikues AQScert, operatori ekonomik nuk provon që punonjësit e kërkuar janë të kualifikuar profesionalisht në specialitetet e kërkuara. Komisioni thekson se, pjesëmarrja në kurse disa orëshe, kursesi nuk vërteton që punonjësi është i kualifikuar apo gëzon aftësitë e duhura në profesionin përkatës. Sqarojmë, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (punonjësit), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se anëtari i bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Mane/S" sh.p.k. është në kushtet e

mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi ky i fundit nuk arrin të përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 11, pika 2.3.3 “Për kapacitetin teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, sipas kontratës së bashkëpunimit, në përputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e cila në nenin 74 pika 3 e cila parashikon shprehimisht se: *“Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.1.8. Në rast se BOE ankimues “Mane/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “Mane/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të BOE ankimues “Mane/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron, pasi BOE nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi operatorësh ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Mane/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-33664-08-16-2019, me objekt: “*Shtesë kati në objektin zyra të Drejtorisë së Rajonit Jugor Gjirokastrë*”, me fond limit 6,246,506 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.08.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1506 protokolli Datë 18.09.2019;**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**